



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 06.04.2023

Nr: 50

Ora: 13:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 45, DATË 02.04.2023 TË DEPOZITUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR "ALEANCA PROGRESISTE LZHK"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia "Aleanca Progresiste LZHK", përfaqësuar nga z. Fabian Topollari;

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 20, datë 30.03.2023 të KZAZ-së nr. 53 të bashkisë Prrenjas

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja "c", 133-136 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia politike “Aleanca Progresiste LZHK”, me vendimin nr. 173, datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndryshuar me vendimin nr. 30, datë 21.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 për “Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, partia “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar në datën 27.03.2023 në KZAZ nr. 52 të bashkisë Prrenjas, dokumentacionin e për regjistrimin e listës shumëmemërore të partisë për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak.

3. KZAZ nr. 53 e bashkisë Prrenjas, pasi konstatoi parregullsi në dokumentacionin e paraqitur, përkatësisht materialet e depozituara për tre nga kandidatët e listës nuk ishin origjinale por fotokopje, i la afat 3 ditë kohë subjektit për korrigjimin e dokumenteve, duke njoftuar me anë të shkresës nr. 24 prot., datë 28.03.2023 “Kërkesë për plotësim dokumentacioni” përfaqësuesin e autorizuar të subjektit zgjedhor.

4. Në datën 30.03.2023, KZAZ-ja nr. 53, bashkia Prrenjas, me vendimin nr. 20 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listës së kandidatëve për këshillat vendorë propozuar nga Partia “Aleanca Progresiste LZHK”, vendosi mosregjistrimin e listës shumëmemërore për kandidatët për këshillin bashkiak në bashkinë Prrenjas të paraqitur nga subjekti zgjedhor partia “Aleanca Progresiste LZHK”, për arsye se dokumentacioni ishte i parregullt.

5. Kundër këtij vendimi, subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore ku pretendon se nuk kishte marrë dijeni për plotësimin e

dokumentacionit të parregullt dhe kërkon shfuqizimin e vendimit nr. 20, datë 30.03.2023 të KZAZ-së nr. 53, Prrenjas dhe regjistrimin e listës shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak në bashkinë Prrenjas të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”.

6. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvin Lako, duke caktuar seancën e shqyrtimit më datë 06.04.2023, ora 13:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, pala ankimuese, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari dhe anëtarë të K.Z.A.Z nr. 53, bashkia Prrenjas.

7. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

-Kërkesën ankimore nr. 45, datë 02.04.2023

- Vendimin nr. 20, datë 30.03.2023 të KZAZ nr. 53, Prrenjas

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Referuar parashikimeve të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 67, pikat 1 dhe 2, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendor, së bashku me dokumentet e kandidimit, depozitohen dhe regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore.
2. Neni 73 i Kodit, ashtu dhe neni 12 i Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përcaktojnë se KZAZ-ja, pasi merr në dorëzim dokumentacionin përkatës verifikon rregullsinë e tij dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Dokumentacioni i korrigjuar më pas depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.

3. Në rastin konkret, partia "Aleanca Progresiste LZHK" ka depozituar në datën 27.03.2023 në KZAZ nr. 52 të bashkisë Prrenjas, dokumentacionin e për regjistrimin e listës shumemërore të partisë për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak.
4. Anëtarët e KZAZ-së nr. 53 Prrenjas, pasi kanë konstatuar parregullsi në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti zgjedhor partia "Aleanca Progresiste LZHK", përkatësisht për depozitimin e formularëve jo origjinalë të dekriminalizimit për tre nga kandidatët e listës shumemërore, të cilit e kishin dorëzuar këtë material fotokopje, si dhe për mungesën e dokumentin që vërteton zotërimin e mandatit nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak, kanë njoftuar përfaqësuesin e subjektit zgjedhor për plotësimin dhe korrigjimin e këtij dokumentacioni.
5. Pretendimi në seancën e shqyrtimit pranë KAS, se subjekti zgjedhor nuk kishte marrë dijeni për plotësimin e të metave të dokumentacionit nuk qendron, pasi anëtarët e KZAZ-së nr. 53 provuan se ky njoftim është bërë me anë të shkresës nr. 24 prot., datë 28.03.2023 "Kërkesë për plotësim dokumentacioni", që i është dërguar përfaqësuesit të autorizuar të subjektit zgjedhor.

Në përfundim të afatit të mësipërm, në datën 30.03.2023, subjekti zgjedhor ka ridepozituar dokumentacionin, ku anëtarët e KZAZ-së përsëri kanë konstatuar parregullsi, përkatësisht në formularët e vetëdeklarimit që ishin përsëri fotokopje dhe në vërtetimin nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak për zotërimin e mandatit që ishte fotokopje.

6. Për këto arsye, bazuar në pikën 2 të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, morën vendimin nr. 20, datë 30.03.2023 për mosregjistrimin e listës shumemërore për shkak të parregullsive në dokumentacion.

Nisur nga fakti se megjithë njoftimin e kryer nga ana e KZAZ-së, subjekti zgjedhor përsëri nuk plotësoi të metat e dokumentacionit të kërkuar, KAS çmon se anëtarët e KZAZ-së nr. 53, Prrenjas, kanë vepruar në përputhje me ligjin, në zbatim të kompetencave të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 143, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, KAS

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 45, datë 02.04.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 20, datë 30.03.2023 të KZAZ nr. 53, bashkia Prrenjas.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Elvin	LAKO	-	Relator	
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar	
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar	
Koli	BELE	-	Anëtar	(Kundër)
Ledio	BRAHO	-	Anëtar	(Kundër)

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 45 të paraqitur nga subjekti zgjedhor partia politike Aleanca Progresiste LZHK me objekt “*Kundërshtimin e vendimit nr. 20, datë 30.03.2023 të KZAZ Nr. 53, Prrenjas*”, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte ankimin e paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK” dhe për rrjedhojë të ndryshonte vendimin nr. 20, datë 30.03.2023 të KZAZ Nr. 53, ndaj paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.
2. Rezulton i provuar fakti se ankimuesi partia politike “Aleanca Progresiste LZHK”, me vendimin nr. 173, datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndryshuar me vendimin nr. 30, datë 21.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
3. K.Zgjedhor, në nenin 67 pika 1 paragrafi i dytë parashikon se **“Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit¹ të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve”**.
4. Në zbatim të dispozitës së sipërcituar, shtetasi Fari Laçka, në cilësinë e personit të autorizuar të subjektit zgjedhor partia “Aleanca Progresiste LZHK”, në datën 27.03.2023 ka depozituar pranë KZAZ nr. 53 dokumentacionin si vijon:
 - Kërkesë për regjistrimin e listës shumëmemërore për anëtarë të këshillit bashkiak propozuar nga parti politike Model KQZ-04-07;
 - Deklaratë për pranimin e kandidimit Model KQZ-04-09;
 - Jetëshkrimi i kandidatit Model KQZ-04-10;
 - Formular i vetëdeklarimit;
 - Dokumentin identifikues për kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak; dhe
 - Autorizim.

¹ Neni 67 pika 1 i K.Zgjedhor - “... jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve”.

Nga "Procesverbali i dorëzimit të dokumentave të kandidimit" i datës 27.03.2023 me Nr. 19 Prot., te rubrika "Vërejtje", në krah të pikës 9 "Deklaratë për pranimin e kandidimit Model KQZ-04-09" është bërë shënimi "Për 3 kandidatë materialet janë fotokopje". Procesverbali është nënshkruar nga i autorizuari i subjektit zgjedhor dhe nga zëvendëskryetarja e KZAZ.

5. Më tej është mbajtur "Procesverbali i dorëzimit të dokumentave të kandidimit" i datës 30.03.2023 nga i cili rezulton se:

- Dokumenti "Kërkesë për regjistrimin e listës shumëmemërore për anëtarë të këshillit bashkiak propozuar nga parti politike Model KQZ-04-07" është ndryshuar nga lista e parë;
- Dokumenti "Formular i vetëdeklarimit" për 4 kandidatë, plotësuese, një nga deklaratat fotokopje përsëri;
- Dokumenti "Vërtetim nga Kuvendi apo Këshilli Bashkiak për zotërimin e mandatit" është fotokopje.

Edhe në këtë rast procesverbali është nënshkruar nga i autorizuari i subjektit zgjedhor dhe nga zëvendëskryetarja e KZAZ.

6. Në vijim, po në datën 30.03.2023, KZAZ nr. 53, me vendimin nr. 20 "Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listës së kandidatëve për këshillat vendorë propozuar nga subjekti zgjedhor "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar" ka vendosur mosregjistrimin e listës së kandidatëve për këshillat vendorë në bashkinë Prrenjas të paraqitur nga subjekti zgjedhor Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Është pikërisht ky vendim që është ankimuar nga subjekti zgjedhor që ju nënshtrua shqyrtimit administrativ nga KAS.

7. Gjatë seancës së shqyrtimit administrativ në KAS, përfaqësuesit e KZAZ nr. 53 prapësuan se kishin arritur në këtë vendimmarrje për shkak se dokumenti "Formular i vetëdeklarimit" i kandidatit Rigels Karriqi (pjesë e listës shumëmemërore të depozituar nga subjekti zgjedhor) kishte qenë sërish fotokopje. Përfaqësuesi në KQZ i subjektit zgjedhor parashtroi se në dijeninë e tij dokumenti i depozituar në lidhje me këtë kandidat kishte qenë origjinal, por megjithatë ai pretendoi gjithashtu se nuk ishte vënë në dijeni për plotësimin e kësaj të mete. Në lidhje me dijeninë për plotësimin e kësaj të mete, përfaqësuesit e KZAZ prapësuan se ata e kishin vënë në dijeni përfaqësuesin e autorizuar të subjektit zgjedhor me anë të shkresës së datës 28.03.2023 me Nr, Prot. 24 dhe me lëndë "Kërkesë për plotësim dokumentacioni".

8. Në lidhje me elementët e sipërcituar, ne anëtarët në pakicë të KAS, argumentojmë se:

- Së pari, në të dy dokumentet "Procesverbali i dorëzimit të dokumentave të kandidimit", si te ai i datës 27.03.2023, po ashtu edhe te ai i datës 30.03.2023, nuk janë identifikuar nominalisht formularët fotokopje, madje nga shënimet në të dy procesverbalet, në atë të datës 27.03.2023 rezulton se fotokopje janë "9. Deklaratë për pranimin e kandidimit Model KQZ-04-09", ndërkohë që në atë të datës 30.03.2023 rezulton se ka një fotokopje të "11. Formular i vetëdeklarimit".

- Së dyti, në lidhje me pretendimin e përfaqësuesve të KZAZ se subjekti zgjedhor është vënë në dijeni të të metave të konstatuara me anë të shkresës së datës 28.03.2023 me Nr, Prot. 24 dhe me lëndë "Kërkesë për plotësim dokumentacioni", nuk arrin të provohet dijenia e personit të autorizuar nga subjekti zgjedhor, pasi vetë shkresa nuk përmban një adresë të personit të cilit i është dërguar.

- Së treti, si neni 7 pika 1 shkronja "e" i Udhëzimit nr. 1, datë 18.01.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore" ashtu dhe neni 73 pika 1 e K.Zgjedhor parashikojnë respektivisht se "1. KZAZ kryen verifikimin e dokumentacionit të kandidimit në lidhje me përputhshmërinë e tij me kërkesat e neneve 67, 68 dhe 72, të Kodit Zgjedhor, duke ndjekur këtë radhë veprimi: ... e) **Në rast se konstatohet mosplotësimi i kushteve/kritereve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, apo mungojnë dokumente, KZAZ-ja i kërkon menjëherë subjektit zgjedhor të bëjë plotësimin e dokumenteve**" dhe "1. KQZ-ja ose, sipas rastit, **KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve**" duke përcaktuar qartësisht se plotësimi/korrigjimi i kërkohen subjektit zgjedhor duke mos lënë të hapur alternativën që një kërkesë e tillë t'i bëhet përfaqësuesit të autorizuar të subjektit zgjedhor.

- Së katërti, në lidhje me afatet, K.Zgjedhor parashikon afatin për depozitimin e listave shumemërore jo më vonë se 50 ditë përpara ditës së zgjedhjeve (27 mars 2023), afatin për kthimin për korrigjim ndaj subjekteve zgjedhore jo më vonë se 45 ditë përpara ditës së zgjedhjeve (30 mars 2023), afatin për të depozituar dokumentacionin e korrigjuar jo më vonë se 42 ditë përpara ditës së zgjedhjeve (3 prill 2023) dhe afatin për miratimin ose refuzimin jo më vonë se 48 orë nga depozitimi i

plotësimit/korrigjimit (5 prill 2023). Kërkesa ankimore (bashkëlidhur të të cilës janë dhe dy Formularë vetëdeklarimi) e depozituar në KAS nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK” mban datën 2 prill 2023, pra është jo më vonë se 42 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, në këto kushte duke qenë se përfaqësuesi i këtij subjekti zgjedhor pretendoi gjatë zhvillimit të seancës administrative në KAS se e kishte Formularin e vetëdeklarimit origjinal për kandidatin Rigels Karriqi, atëherë kjo provë duhej administruar dhe të ishte konsideruar si dokumentacion i korrigjuar.

9. Për sa më sipër, për aq kohë sa nga procesverbalet e dorëzimit të dokumentacionit (të datave 27.03.2023 dhe 30.03.2023) dhe nga vetë vendimi nr. 20 datë 30.03.2023 i KZAZ nr. 52, nuk del qartë dhe në mënyrë nominale dokumentacioni që duhet të plotësohet/korrigjohej nga subjekti zgjedhor, mund të themi se jemi në kushtet e një akti administrativ të arsyetuar në mënyrë jo të qartë në zbatim të nenit 100 të K.Pr.Administrative. Po ashtu, për aq kohë sa nuk vërtetohet dijenia e subjektit zgjedhor apo e përfaqësuesit të autorizuar të tyre për dokumentacionin që duhej plotësuar/korrigjuar në mënyrë nominale dhe kërkesa ankimore në KQZ është depozituar jo më vonë se 42 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, jemi në kushtet që rrëzimi i kësaj kërkesë ankimore çënon parimin e pluralizmit, parim ky i trajtuar dhe nga vendimi nr. 32, datë 21.06.2010 i Gjykatës Kushtetuese, por tashmë së fundmi dhe nga vetë Kolegji Zgjedhor në vendimin nr. 4, datë 21.03.2023.

10. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimesi subjekti zgjedhor partia “Aleanca Progresiste LZHK” është e bazuar në ligj dhe ajo duhej të ishte pranuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që duhet të ishte shfuqizuar vendimi nr. 20, datë 30.03.2023 i KZAZ Nr. 53 dhe duhet të detyrohej kjo e fundit që të regjistronte listën e kandidatëve për këshillat vendorë, në bashkinë Prrenjas për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 të propozuar nga subjekti zgjedhor partia “Aleanca Progresiste LZHK”.

Anëtarë: Koli Bele, Ledio Braho